



NJOFTIM PËR KONTRATË

Furnizim

Procedurë e hapur

*Në përputhje me Nenin 6 të Rregullave të Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
(Shtator 2021)*

Datë: 03.11.2023

Nr. i Prokurimit: BQK 23 051 121

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452.	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: “Furnizim me një gjenerator për nevojat e BQK-së”
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): n/a
Variantet pranohen: n/a
Vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 Eur.
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjedhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale furnizimin me gjenerator, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndalet.

IV KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik</p>	<p><u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 2:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 2:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 3:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 3:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinali ose kopja e noterizuar).</p> <p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre.</p>
<p>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale</p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>

<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	<p><u>Kërkesa 5:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës se ngjashme përgjatë 3 viteve të fundit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Ofertuesi duhet të plotësoj formularin standard të dhënë në dosjen e tenderit dhe të bashkëngjis vetëm kopjet e kontratave dhe referencat/certifikatat që evidentojnë përformimin e tillë.</p>
	<p><u>Kërkesa 6:</u> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogun- me specifika teknike, detaje të artikullit të ofruar për pajisje (sipas kërkesës në tabelen e specifikave teknike).</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Katalogu me specifika teknike të produktit të ofruar të ketë të shënuar qartë produktin e ofruar , ashtu sic është kërkuar në specifikat teknike.</p> <p><u>Kërkesa 7:</u> Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike, të cilat garantojnë që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 2, si pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Të dorëzohet deklarata e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike, të cilat garantojnë që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 2, si pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.</p>
<p>III.1.3) Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>Banka Qendrore mund të dëshirojë, me shpenzimet e saj, të kryej një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapaciteteve disponuese vërtetimin e cilësisë dhe çdo informatë tjetër që është e nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund të realizoj kontratën.</p>

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: ‘‘Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët’’.

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

<p>Kushtet për marrjen e e dosjes se tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 14.11.2023 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 13.11.2023, ora 14:00</p>
<p>Dokumentet me pagesë: Jo</p>
<p>Siguria e tenderit: 5000.00 € (pesë mijë euro) për periudhë valide prej 90 dite.</p>
<p>Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i liferimit.</p>
<p>Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes.</p>

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave :16.11.2023, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.

Takimi për hapjen e ofertave:16.11.2023, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

VIII INFORMATA PLOTËSUESE

VIII.1 ANKESAT

Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore.

VII.2 ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni I Prokurimeve	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763